

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2015

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë¹.)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore
1.10.15		12,600.00	3,500.00	
8.10.15		12,950.00	3,380.00	
15.10.15		20,520.00	3,300.00	
22.10.15		25,250.00	3,450.00	
23.10.15	3,570.00			
26.10.15				2,000.00
29.10.15		21,080.00	3,500.00	
5.11.15		22,270.00	3,150.00	
12.11.15		20,730.00	3,000.00	
19.11.15		21,740.00	2,700.00	
23.11.15	4,680.00			
26.11.15		18,270.00	2,570.00	
3.12.15		18,920.00	1,750.00	
10.12.15		10,900.00	2,200.00	
17.12.15		13,010.00	2,500.00	
23.12.15	2,940.00			
24.12.15		8,930.00	2,500.00	
31.12.15		3,680.00	1,500.00	

pjesëmarrjes në ankande.

Për injektimin e likuiditetit të përkohshëm, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor në mesatarisht 16.0 mld lekë kundrejt mesatarisht 20 miliardë lekëve në ditë në tremujorin e mëparshëm, ndërsa injektimet njëmujore qenë mesatarisht 10.8 mld lekë kundrejt 14 mld lekëve në tremujorin e tretë. Gjatë tremujorit të fundit të vitit është rinovuar për 2 mld lekë maturimi 3-mujor prej 2.45 mld lekësh i muajit korrik, ndërsa injektimet 3-mujore të muajit gusht dhe shtator u maturuan. Megjithatë, injektimi mesatar ditor i likuiditetit nëpërmjet këtij instrumenti u rrit në 4.2 miliardë lekë kundrejt 2.3 miliardë lekëve një tremujor më parë.

1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015 përbëhen nga operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 31.1² mld lekë kundrejt 36.4 mld lekëve në tremujorin e mëparshëm. Nevoja për likuiditet ka ardhur në rënie si rezultat i plotësimit të nevojave për financim të Ministrisë së Financave nga tregu i jashtëm dhe jo nga tregu i brendshëm.

Banka e Shqipërisë ka ulur portofolin e saj me rreth 10.9 mld lekë në operacionet e blerjes para maturimit të Ministrisë së Financave dhe nëpërmjet uljes së

¹ Shifrat janë në vlerë nominale.

² Shifrat janë me çmim blerjeje.


Operacioni injektues njëditor është përdorur në tre raste në ditën e fundit të mbajtjes së rezervës së detyruar për mesatarisht 3.4 mld lekë. Një tremujor më parë, ky operacion është përdorur vetëm një herë dhe me të njëjtin objektiv.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Kredia njëditore është përdorur në 7 raste gjatë tremujorit të kaluar kundrejt vetëm 2 rasteve të një tremujori më parë, për mesatarisht 2.9 mld lekë. Depozita njëditore nuk është përdorur në asnjë rast dhe që nga fillimi i muajit nëntor, me uljen e normës bazë, norma e depozitës njëditore ka rënë në 0.0%.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2009-2015.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2009-2015 (me vlerë nominale)




2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2015

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015, Banka e Shqipërisë ka realizuar ankandin e katërt dhe të fundit të blerjes së valutës me objektiv rritjen e rezervës valutore të planifikuar për vitin 2015. Shuma e shpallur për blerje për këtë ankand që e njëjtë me ankandet e tjerë të organizuar gjatë vitit 2015 në 2-5 milionë euro. Në këtë ankand u blenë 5.0 milionë euro.

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e katërt të vitit 2015



2.2 Veprime me institucione të tjera

Në tremujorin e katërt të vitit kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë kundrejt lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit, që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj nëpërmjet investimit pranë BSH-së të tepricave në valutë. Shumat e investuara në marrëveshjet *swap* janë rritur në 330 milionë euro në fund të tremujorit të katërt, nga 0 që shënonin në fund të atij të mëparshëm, ndërkohë që ato në SDR kanë rënë në 50 milionë nga 65 milionë në fund të tremujorit të tretë. Si rezultat i marrëveshjeve *swap* të lidhura në tremujorin e katërt, blerjet e Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 73,178.50 milionë lekë dhe shitjet qenë 73,693.41 milionë lekë³.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 70.00 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	73,178.50	73,693.41
TË TJERA (IDA, IBRD)	70.00	

³ Llogaritur sipas datës së lidhjes së marrëveshjes